

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Shqipëria ka ndryshuar", Rama fjalim në mbrëmjen gala në New York: Sot korrupsioni luftohet çdo ditë – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/shqiperia-ka-ndryshuar-rama-fjalim-ne-mbremjen-gala-ne-new-york-sot-korrupsioni-luftohet-cdo-dite/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 14:20:13 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 14:18:52 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c174495c89787d0d156ee4c9523a9a65e9eefa90a9ab1ae06ec77e9215b11d0e
TEKSTI	1eba62535fc63ac35092036e8458734001cde96526825769eb9f13f09d0a6cc6
PAMJA	0db43fb9e749020b9c3b1aff9276f0c1ff6b8b855e93374b91c4805df648eae1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f7154bef77f1b88a381a0db38dd541593ebcddd648c7a48e0b1cd6eda6760826
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3a6c0ee943067392b175e06ac07a7b9996bbd474953cea4f063ab0e555023da
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f7154bef77f1b88a381a0db38dd541593ebcddd648c7a48e0b1cd6eda6760826>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Shqipëria gjatë viteve të fundit, duke veçuar zhvillimin ekonomik, rritjen e infrastrukturës dhe forcimin e institucioneve në luftën kundër korrupsionit.

Gjatë fjalimit në mbrëmjen gala të Këshillit për Marrëdhëniet Shqiptaro-Amerikane në Nju Jork, Rama u ndal te zhvillimi i aeroportit të Tiranës dhe rritja e numrit të udhëtarëve.

"Sa shumë ka ndryshuar Shqipëria gjatë këtyre viteve. Askush nuk ta fal suksesin. Po, është viti i pestë a i gjashtë, që kemi aeroportin më të madh në rajon. Duke qenë shumë i madh jo vetëm në terma relative, që është aeroporti me rritjen më të madhe në Europë, por edhe me shifra absolute, me më shumë udhëtarë se aeroporti i Beogradit. Do të vazhdojë sepse është vetëm fillimi", deklaroi ai.

Duke folur për korrupsionin, kryeministri tha se Shqipëria ka ndryshuar edhe në mënyrën se si institucionet përballen me këtë fenomen.

REKLAMË

"Dikur në Shqipëri, korrupsioni ishte gjithkund dhe lufta askund. Sot shohim diçka ndryshe. E shohim sepse sistemi demokratik i Shqipërisë ka nisur të ndërtojë imunitetin e vet. Është fjala për një sistem pushtetesh të pavarura që funksionojnë me gjithë defektet, problemet dhe nevojën për t'u rritur, por sidoqoftë duke shfaqur çdo ditë faktin që ky nuk është vendi ku mund të ecësh dorë për dore me korrupsionin pa asnjë pasojë", u shpreh Rama.

Ai përmendi gjithashtu ndryshimet në mbrojtjen e mjedisit dhe

5 Me skarander në koke dhe armë në dorë, foto e autorit të dyshuar të...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

emaili juaj

Abonohu

REKLAMË

biodiversitetit, duke theksuar ndalimin e gjuetisë, zgjerimin e zonave të mbrojtura dhe masat për pyjet.

“Ky është sukses i madh për një vend ku 10 vjet më parë, kafshët dhe shpendët masakroheshin nga mijëra gjuetarë europianë që kalonin në kufirin tonë, që të bënin festë pa rregulla e kontrole, të vrisnin majtas dhe djathtas duke lënë pirgje zogjsh të ngordhur. Sot vendi proteston për biodiversitetin, vetëm 10 vjet më vonë, pasi ndaluam gjuetinë, rritëm zonat e mbrojtura dhe pasi ndaluam shfrytëzimin e pyjeve, rritëm trefish numrin e shpendëve dhe kafshëve, rritëm shumëfish si kurrë më parë sipërfaqen e pyjeve të rikuperuara”, tha kryeministri.

Në përfundim, Rama tha se ndryshimi i Shqipërisë ka sjellë edhe rritjen e pritshmërive të qytetarëve.

“Tashmë kemi një Shqipëri të re. Njerëzit duan më shumë. Shqipëria ku njerëzit jetonin me idenë se mund të jetë më keq nuk ekziston më”, deklaroi Rama.

#NewYork

#rama

#ramanenewyork



WRITTEN BY

Ana Miha

Gazetar/e · Vizion Plus

Të gjithë artikujt →

Vazhdo të lexosh



POLITIKË

**Rama në New York:
Hashim Thaçi nuk...**

Ana Miha · 25 Sht 16:12



POLITIKË

**“100 bashki dhe 12
qarqe”, PD depozito...**

Elisjeda Kiko · 25 Sht
15:38



POLITIKË

**Këshilli Bashkiak
kërkon Veliajn: Të...**

Elisjeda Kiko · 25 Sht
14:41

REKLAMË

Lini një koment

Komenti juaj *

Me respekt — komentet moderohen nga redaksia.

Emri *

E-mail *

Nuk publikohet kurrë.

☐ Ruaje emrin dhe e-mailin tim në këtë shfletues për herën tjetër që komentoj.

Posto komentin



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale